



Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 28.12.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berat Lahu (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejtë (LDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB), dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

Munguan: Besnik Mujeci (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Taulant Maxharraj (AAK), Amir Simnica (LDK) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rrëth pikave të rendit të ditës.

Për këtë mbledhje ishte paraparë ky

Faqelnga4

Rend i ditës:

1. Miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 dhe
2. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike", në Prishtinë.

Pika e parë

Miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Alban Zogaj, nënkyetar, në emër të Drejtorisë së Pronës, në mungesë të drejtore së kësaj drejtorie, para të pranishmëve bëri një prezantim të shkurtër lidhur me listën e veçantë të pronave, duke thënë se ne si ekzekutiv kemi vendosur që të përfshijmë në këtë listë të gjitha pronat e Komunës së Prishtinës, duke përjashtuar nga kjo listë, zonat e mbrojtura, siç janë Parku i Gërmisë, Badovci, rrugët e Komunës së Prishtinës, shkollat, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe pronat e tjera të cilat janë në shfrytëzim në Komunën e Prishtinës.

Natyrisht, dhënia në shfrytëzim e pronave komunale tash do të krijojë edhe të hyra shtesë për kryeqytetin, pas hyrjes në fuqi të rregullores për dhënien në shfrytëzim për më pak se një vit. Po ashtu, sipas kritereve ligjore, ne do të japim edhe mundësi shtesë, ashtu siç parashihen me ligj, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim, për afate deri në 15 vjet, e gjithashtu edhe përafatë deri në 99 vjet.

Gjithashtu, propozoi që në këtë listë të veçantë të pronave të hyjë edhe prona e shkollës "Don Bosko".

Ju ftoj që ta votoni këtë listë të veçantë, në mënyrë që t'iu japim shans qytetarëve dhe bizneseve, që nëpërmjetë shfrytëzimit të pronës komunale, t'i rrisin të hyrat edhe për kryeqytetin, por edhe për shoqërinë e vendin në përgjithësi.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Zogaj, nënkyetar, që prona e shkollës filllore dhe të mesme "Don Bosko", me nr. 2902-2, Zona kadastrale Prishtinë, të futet në listën e veçantë të pronave.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratua propozimi që parcela e shkoës filllore dhe të mesme "Don Bosko", me nr. 2902-2, Zona kadastrale në Prishtinë, të futet në listën e pronave të veçanta që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Gëzim Sveçla, në emër të GP të LVV-së, tha se vërejtjet tona kanë të bëjnë me mënyrën se si na është prezentuar kjo listë e pronave, një çështje shumë e rëndësishme që ka të bëjë me zhvillimin e qytetit. Në një seancë të jashtëzakonshme, ku materialin e kemi pranuar 48 orë para seancës, një material mjaft voluminoz, me afërsisht 5000 çertifikata të pronës, do të thotë që është e pamundur për t'i kontrolluar vetëm manualisht, pa u theluar në to. Kjo çka po ndodh është rezultat i qasjes suaj të cilën e keni shpërfaqur gjatë vitit që po e lëmë

Faqe2nga⁴

pas, një arrogancë e panevojshme, një mungesë bashkëpunimi dhe kooperimi, e cila rezulton me veprime të tilla siç është ky i sotshmi. Është krijuar një ambient toksik, kisha me thanë, në Kuvend, që nuk i kontribuon proceseve të kryeqytetit, por nëse kthehem i një retrospektivë dhe i analizojmë veprimet qysh nga qershori, fajtorët kryesor jeni ju. Ju jeni prijësit që duhet t'i udhëhiqni këto procese, ju jeni ata të cilët duhet ta konsultoni dhe ta respektoni opozitën, jo vetëm kur nuk i keni numrat, por çdo herë kur të bëhet fjalë për procese të rëndësishme. Shpresoj që në të ardhmen mos të kemi veprime të tillë, shpresojë që edhe nga aspekti teknik, por edhe nga ai politik, të reflektoni dhe të kemi një bashkëpunim më të mirë në vitin që po hyjmë.

Jeta Rafuna - Hasani tha se kjo lisëtë është gjithëpërfsirëse dhe është një lajmë i mirë për të gjithë qytetarët e Prishtinës, që sa më shumë qytetarë që mund të përfshihen në proceset e Komunës. Ne si Grup i asambleistëve të LDK-së, e përkrahim këtë përfshirje dhe gjithashtu propozojmë që në një afat sa më të shkurtër të seancës së radhës, të formojmë edhe komisionin e Kuvendit komunal dhe të hapet ankandi për dhëni e pronave në shfrytëzim.

Bahri Gashi kërkoi të dijë se lista e prezantuar a është e veçant, apo e përgjithshme. Kjo listë ka shumë parregullsi dhe nuk e di a e keni shikuar se çfarë keni dashtë me bërë!

Bujar Qunaku, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës, tha se lista e prezantuar është listë e veçant e pronave komunale e propozuar për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Bahri Gashi tha se ju që në fillim e keni shkelur rregulloren dhe ligjin, e keni sjellë një listë të veçantë pa listën e përgjithshme, kjo mendoj se është gabim, është shkelje ligjore.

Bujar Qunaku tha se lista e përgjithshme nuk kalon përmes procedurës së Kuvendit, por bëhet publike direkt nga kryetari, ndërsa lista e veçantë duhet t'i nënshtronhet procesit përmes Kuvendit.

Gëzim Mehmeti theksoi se pronat komunale kanë një rëndësi të veçantë sa i përket planifikimit afatgjatë, të cilin interesin e qytetarit e kanë si pikësynim dhe duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë pronat dhe rëndësinë që kjo të kalojë, sepse po nuk kalojë sot, do të jetë e vështirë të bëhet planifikimi dhe të fitojë legjitimitetin.

Kontestuese për mua është procedura, në këtë rast me një volum kaq të madhe të dokumentacionit, thuaqse është e pamundur që ne brenda 48 orëve të kemi mundësi, që sadopak të dimë se çka po votojmë, e cila është edhe pjesë përbërëse e çështjeve të votimit.

Berat Lahu u shpreh se të kalojë një vit dhe mos të përgatitet lista e pronave komunale për shfrytëzim, kjo për mua është shqetësuese dhe votimi i kësaj liste është shkelje ligjore. Me u thirrur në institucionalizëm e më së shumti me shkel procedurën që është bazë e institucionalizimit, nuk ka kurrrfarë logjike.

Faqe3nga4

Fikneta Bejta tha se, si një asambleiste, mendoj se e mira e përgjithshme është me rëndësi, sepse ne nëse nuk e trajtojmë këtë mundësi për qytetarët e Prishtinës, atëherë humbin disa mundësi për të realizuar të hyra vetanake komunale të këtyre pronave nga këto subjekte juridike dhe fizike.

Lidhur me vërejtjet dhe çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Alban Zogaj, nënkyretar, dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 15 vota për, 18 kundër, nuk u bë miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024.

Pika e dytë

Propozim vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike", në Prishtinë.

Lidhur me këtë propozimvendim, arsyehmërinë për votimin e tij e paraqiti Mimoza Sylejmani, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se është mirë që janë bërë ato përmirësime nga hera e kaluar, disa informata që i kemi pasur, kështu që nuk kemi diçka konkrete për këtë pikë.

Gëzim Mehmeti tha se baza juridike në të cilën ne po thirremi nuk qëndron, në këtë rast kemi iniciuar po ashtu një rast të revidimit të planit, duke u bazuar në një shkresë të Ministrisë, ku e ka vlerësuar se akti i Kuvendit nuk ka vlefshmëri të ligjshmërisë. Nëse edhe sot e votojmë këtë plan, mendoj se prapë do të ketë përgjigje negative nga ministria kompetente.

Kryesuesi konstatoi se më 15 vota për dhe 19 kundër, nuk u miratua Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike", në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 18:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

Faqe4nga4

**Kryesues i Kuvendit
Pëllumb Bajçinovci**

